

FIRST INVESTMENT BANK - ALBANIA SH.A.

Pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(dhe raporti i auditorit të pavarur)

PËRMBAJTJA

PAGE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	1
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015	2
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	3
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	4
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	6 - 47

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtimit të Bankës së Parë të Investimeve

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës së Parë të Investimeve ("Banka"), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës së Parë të Investimeve sh.a. më 31 dhjetor 2015 si dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa kualifikuar mbi ato pasqyra në 9 mars 2015.

BDO ALBANIA SHPK

BDO Albania sh.p.k.
7 mars 2016
Tiranë, Albania

Limos Malaj
Partner Angazhimi

BDO

BDO ALBANIA sh.p.k.
NIPT L02407004C
TIRANA - ALBANIA

Pasqyra e të ardhurave përmblëdhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat		992,546	1,033,249
Shpenzime për interesat		(265,138)	(416,562)
Të ardhura neto nga interesat	7	727,408	616,687
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		207,820	210,176
Shpenzime për tarifat dhe komisionet		(35,543)	(34,666)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	8	172,277	175,510
Të ardhurat neto nga tregëtimi	9	(26,054)	8,493
Të ardhura të tjera operative		1,275	761
Totali i të ardhurave nga veprimtaria bankare		874,906	801,451
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	19	(118,271)	(238,349)
Shpenzime personeli	10	(181,709)	(167,320)
Shpenzime të qerasë		(70,573)	(72,520)
Zhvlerësimi dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme	20,21	(32,456)	(30,849)
Shpenzime të përgjithshme administrative	11	(165,193)	(157,448)
Shpenzime të tjera, neto	12	(9,355)	(11,188)
		(577,557)	(677,674)
Fitimi / (Humbja) para tatimit		297,349	123,777
Tatimi i shtyrë	13	(46,402)	(26,285)
FITIMI/(HUMBJA) PËR VITIN		250,947	97,492
Të ardhura/(humbje) përmblëdhëse të tjera, neto nga tatimi mbi fitimin		83,396	(11,701)
TOTALI I TË ARDHURAVE/(HUMBJEVE) PËRMBLËDHËSE PËR VITIN, QË I PËRKASIN AKSIONERËVE		334,343	85,791

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 6 deri në faqen 47 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë

	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Arka dhe Banka Qëndrore	14	226,854	234,623
Shuma të kushtëzuara	15	1,391,421	1,381,314
Investime të mbajtura për shitje	16	5,379,780	2,663,518
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	17	1,957,557	2,470,853
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	18	1,238,433	2,872,821
Hua dhe paradhënie për klientë	19	6,198,085	5,869,704
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	20	99,554	120,430
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	21	26,763	8,974
Aktive të mbajtura për shitje	22	298,536	232,778
Aktive të tjera	23	123,011	90,302
Aktive tatimore të shtyra	13	-	3,302
GJITHSEJ AKTIVET		16,939,994	15,948,619
PASIVET			
Detyrime ndaj bankave	24	197,855	-
Detyrime ndaj klientëve	25	14,709,329	14,305,614
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	26	135,035	-
Detyrime të tjera	27	56,348	146,943
Detyrimi i tatimit të shtyrë	13	11,022	-
Gjithsej detyrimet		15,109,589	14,452,557
Kapitali i paguar	28	1,516,517	1,516,517
Rezervë rivlerësimi për investimet e mbajtura për shitje		102,772	19,376
Humbje të akumuluar		211,116	(39,831)
Kapitali aksioner		1,830,405	1,496,062
GJITHSEJ PASIVET DHE KAPITALI AKSIONER		16,939,994	15,948,619

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 6 deri në faqen 47 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitim (Humbja) neto për periudhën		250,947	97,492
<i>Zërat jo monetarë në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse</i>			
Humbjet neto nga zhvlerësimi i huave	19	118,271	238,349
Amortizimet	20,21	32,456	30,849
Të ardhurat neto nga interesat	7	(727,408)	(616,687)
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	13	46,402	26,285
Humbje nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		570	1,626
		(278,762)	(222,086)
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Ndryshimi në hua për klientët		(450,168)	410,474
Ndryshimi në aktive të tjera		(105,483)	(109,057)
Ndryshimi në rezervat e detyrueshme		(10,107)	(101,195)
Ndryshimi në depozitat nga bankat		197,864	(198,852)
Rritje të detyrimeve ndaj klientëve		353,977	(1,168,987)
Ndryshimi në detyrime të tjera		(59,113)	75,717
Interesi i paguar		(215,309)	(348,520)
Interesi i arkëtuar		1,008,158	1,021,008
Tatimi mbi të ardhurat i paguar		(56,544)	(2,745)
FLUKSET E PARASË NGA / (TË PËRDORURA PËR)AKTIVITETET OPERACIONALE		384,513	(645,869)
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet investuese:			
Të ardhura neto nga blerjet dhe maturimin e investime		(2,131,666)	(376,701)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara		(22,006)	(2,719)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(7,933)	(8,711)
FLUKSET E PARASË TË PËRDORURA PËR AKTIVITETET INVESTUESE, NETO		(2,161,605)	(388,131)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese:			
Rritje në huamarrje		134,935	-
FLUKSET E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE, NETO		134,935	-
RËNIA NETO E PARASË GJATË VITIT		(1,642,157)	(1,034,000)
AKTIVET MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO NË FILLIM TË VITIT	31	3,107,444	4,141,444
AKTIVET MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO NË FUND TË VITIT	31	1,465,287	3,107,444

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 6 deri në faqen 47 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë

	<i>Kapitali i paguar</i>	<i>Humbjet e mbartura</i>	<i>Rezerva rivlerësimi për investime të mbajtura për shitje</i>	<i>Gjithsej</i>
Gjëndja më 1 janar 2014	1,516,517	(137,323)	31,077	1,410,271
Gjithsej të ardhura përmbledhëse për periudhën				
Fitimi i periudhës	-	97,492	-	97,492
Të ardhura të tjera përmbledhëse, para tatimit mbi fitimin	-	-	(11,701)	(11,701)
Gjithsej (humbjet) /të ardhura përmbledhëse për vitin	-	97,492	(11,701)	85,791
Veprime me aksionerët e regjistruar direkt në kapital				
Kontribute nga aksionerët				
Kapital i paguar	-	-	-	-
Gjithsej kontribute nga dhe shpërndarje për aksionerët	-	-	-	-
	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2014	1,516,517	(39,831)	19,376	1,496,062

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 6 deri në faqen 47 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
 në mijë Lekë

	<i>Kapitali i paguar</i>	<i>Humbjet e mbartura</i>	<i>Rezerva rivlerësimi për investimet e mbajtura për shitje</i>	<i>Gjithsej</i>
Gjëndja më 1 Janar 2015	1,516,517	(39,831)	19,376	1,496,062
Gjithsej të ardhura përmbledhëse për periudhën				
Fitimi i periudhës	-	250,947	-	250,947
Të ardhura të tjera përmbledhëse, para tatimit mbi fitimin	-	-	83,396	83,396
Gjithsej të ardhura përmbledhëse për vitin	-	250,947	83,396	334,343
Veprime me aksionerët e regjistruar direkt në kapital				
Kontribute nga aksionerët				
Kapital i paguar	-	-	-	-
Gjithsej kontribute nga dhe shpërndarje për aksionerët	-	-	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	1,516,517	211,116	102,772	1,830,405

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 6 deri në faqen 47 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi më **7 Mars 2016** dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Bozhidar Todorov
 Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Elma Lloja
 Drejtor Ekzekutiv

Edvin Liko
 Drejtor i Departamentit të
 Financës dhe Kontabilitetit



Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

1. Të përgjithshme

Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri (Banka) është themeluar në Republikën e Shqipërisë si shoqëri anonime më 1 Gusht 2005 dhe e ka selinë e saj qendrore në Tiranë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14.

Banka është e licensuar nga Banka e Shqipërisë (BSh) më 6 Korrik 2007, në bazë të së cilës asaj i lejohej të kryejë të gjithë veprimet bankare të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Banka është kryesisht e përfshirë në shërbimet bankare të korporatave dhe atyre retail.

Banka gjithashtu është licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer shërbimet e depozitarit, kujdestarit dhe brokerimit.

Banka është një filial i Bankës së Parë të Investimeve A.D. (më pas "Mëma"), një entitet i krijuar në Bullgari si institucion financiar e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. Para licensimit ajo ka operuar si një degë e huaj e Mëmës në Shqipëri që nga Shkurti i vitit 1999.

Struktura e aksionarëve të Mëmës më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

Aksionarët	% e kapitalit aksionar
Z. Ivailo Dimitrov Mutafchiev	42.50
Z. Tzeko Todorov Minev	42.50
Aksionarë të tjerë (aksionarë të cilët kanë aksione të cilat tregtohen në Tregun e Aksioneve në Bullgari-Sofie)	15.00
Totali	100.00

Zyrat qendrore të Bankës së Parë të Investimeve - Albania sh.a. ndodhen në Tiranë. Rrjeti i degëve përfshin 9 degë. Dy degë ndodhen në Tiranë (Tirana 1, Twin Towers) dhe degët e tjera ndodhen në: Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Fier, Berat dhe Vlorë.

Banka ka 126 (31 dhjetor 2014: 122) punonjës më 31 dhjetor 2015.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç aktiveve financiare të mbajtura për shitje, të përgatitura mbi bazën e vlerës së drejtë.

c) Monedha e funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Bankës, shumat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

Drejtimi ka zgjedhur Lek-un si monedhë funksionale të Bankës për faktin se Banka operon në një ambient në të cilin çmimet, në gjykimin e Drejtimit, janë të ndikuara nga monedha vendase Leku. Kostot dhe kontratat janë të ndikuara nga Leku, edhe nëse emërtimi i tyre formal, është në një monedhë të ndryshme.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të gjykojë, bëjë vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e pasqyruara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë në bazë të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet mbi vlerësimet kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet, si dhe në çdo periudhë të ardhme që vlerësimi ka ndikim.

Në shënimin 5 jepet informacion mbi vlerësimet dhe gjykimet kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikuar më shumë në vlerat kontabël të njohura në pasqyrat financiare.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmben në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të nominuara në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale në atë datë. Humbja ose fitimi nga këmbimet valutore i mjeteve monetare është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedha të huaja të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerë të drejtë në monedha të huaja këmben në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Mjetet jo-monetare të cilat maten me kosto historike në monedhë të huaj këmben duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

b) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që merr në konsideratë zbritjen e pagesave dhe arkëtimeve të ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivitetit ose pasivitetit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) nga vlera kontabël e aktivitetit ose pasivitetit financiar. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset e ardhshme të parasë duke marrë në konsideratë të gjitha termat kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një aktivi apo pasivi financiar.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**c) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv të një aktivi ose pasivi financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera nga tarifatat dhe komisione lindin nga shërbimet financiare që ofrohen nga Banka dhe njihen kur shërbimi përkatës merret ose jepet.

d) Të ardhura neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përbëhen kryesisht nga fitimet duke zbritur humbjet të realizuara dhe të parealizuara nga diferencat në kurset e këmbimit.

e) Pagesat e qiramarrjes

Pagesat e bëra për qeratat operative janë njohur në fitim ose humbje me metodën lineare mbi termat e qerasë. Lehtësimet në qera të përfituara janë njohur si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qeratat në përputhje me termat e kohëzgjatjes së qerasë.

Pagesat minimale të qerasë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe reduktimit të detyrimit të papaguar. Shpenzimi financiar është shpërndarë në secilën periudhë përgjatë termave të qerasë financiare në mënyrë të tillë që të prodhojë një normë konstante interesi për gjëndjen e mbetur të detyrimit.

Angazhimet e pagesave të qerasë janë marrë parasysh duke rishikuar minimumin e pagesave për pjesën e mbetur të qerasë kur korrigjimi për qeranë konfirmohet.

f) Shpenzime për tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç se kur lidhet me zërat për të cilat njihet direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo korrigjim për taksat e pagueshme nga vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin ose humbjen kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndiqnin mënyrën që Banka pret për të rikuperuar vlerën e mbartur të aktiveve dhe pasiveve të saj, në fund të periudhës së raportimit.

Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë bazuar në ligjet të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**f) Shpenzime për tatimin mbi fitimin (vazhdim)****(ii) Tatimi i shtyrë (vazhdim)**

Tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve netohet nëse ka një detyrim ligjor për të netuar tatimin aktual të pasiveve me tatimin aktual të aktiveve, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që jepet nga i njëjti autoritet tatimor për të njëjtën njësi ekonomike të tatueshme.

Tatimi i shtyrë i aktiveve njihet për humbjet fiskale të mbartura dhe të papërdorura, tatimin e kredituar dhe diferenca të përkohëshme të zbritshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të përdoren, ndaj të cilave ato mund të mundësohen. Tatimi i shtyrë i aktiveve rishikohet në çdo datë raportimi dhe ulet në atë masë që nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Banka merr në konsideratë efektin e situatave të pasigurta nga ku mund të lindin detyrime shtesë në lidhje me taksat. Ky vlerësim bazohet në supozime dhe parashikime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të së ardhmes. Informacione të reja të mundshme mund të bëjnë Bankën të ndryshojë gjykimin e saj përse i përket saktësisë së detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të mundshme në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin për tatimin në periudhen në të cilën ky konstatim do të bëhet.

g) Aktivitet dhe pasivitet financiar**(i) Njohja**

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat, instrumentat e borxhit dhe borxhin e varur në datën e origjinës. Mënyrat e rregullta të blerjes dhe shitjes së aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka kryen blerjen ose shitjen e aktiveve. Të gjithë aktivitet dhe detyrimet financiare e tjera fillimisht njihen në datën kur Banka bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit të cilat kanë të bëjnë direkt me blerjen ose emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi**Aktivitet financiar**

Banka klasifikon aktivitet financiar në një nga kategoritë e mëposhtme:

- huatë dhe paradhëniet për klientët;
- investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim;
- Investimet në letra me vlerë të mbajtura për shitje;

Shiko politikat kontabël 3. (h,i dhe j)

Pasivitet financiar

Banka klasifikon pasivitet financiar, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, mbi bazën e kostove historike ose vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave dhe shpërblimeve. Shiko shënimin 3.o.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)****(iii) Çregjistrimi (Mosnjohja)****Aktivitet financiare**

Aktivitet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Banka ia transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në bilancin e saj kontabël, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin e transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitet e transferuara nuk çregjistrohen. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha ose pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull shit/blerjen e letrave me vlerë të blera/shitura sipas marrëveshjeve të shit/blerjes. Në transaksionet në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e lidhura me aktivin financiar, e çregjiston aktivin nëse humbet kontrollin mbi të. Të drejtat dhe detyrimet të ruajtura gjatë transferimit njihen vecmas si aktive dhe detyrime siç është më e përshtatshme. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitet të transferuar.

Në disa transaksione, Banka mban të drejtat për të marrë ose kryen shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht në qoftë se ai i përmbush kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për kontratën e shërbyer, në qoftë se tarifa e shërbimit është shumë më e përshtatshme (aktiv) ose shumë më pak e përshtatshme (detyrim) për të kryer shërbimin. Banka nxjerr jashtë bilanci kreditë kur ato janë përcaktuar si të paarkëtueshme (shiko shënimin 3.g.vii).

Pasivitet financiare

Banka çregjiston pasivitet financiare nëse të drejtat kontraktuale të Bankës janë anuluar ose kanë mbaruar.

(iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë me bazë netimi ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme sic janë ato për aktivitet tregëtimi nga Banka.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, shtuar ose zbritur amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)****(vi) Matja me vlerë të drejtë**

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve që kanë njohuri dhe mundësi të kryejnë një transaksion në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes.

Kur është e mundshme, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur cmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse cmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale të tregut dhe që ndodhin rregullisht.

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka përllogarit vlerën e drejtë duke përdorur një metodë vlerësimi. Metoda e vlerësimit përfshin përdorimin e transaksioneve të ndodhura së fundmi në kushte normale tregu midis palëve që kanë pasur si njohurinë dhe dëshirën (nëse është e disponueshme), përdorimin si referencë të vlerës së drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara si dhe modelet opsionale të cmimit. Metoda e zgjedhur e vlerësimit merr në konsideratë sa më shumë që të jetë e mundur të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në përllogaritjet specifike të Bankës, merr parasysh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e cmimit dhe është konsistente me metodologjitë ekonomike të pranuar për vendosjen e cmimit të instrumentave financiare. Faktorët e metodave të vlerësimit paraqesin pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë. Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg.

Evidenca më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, që do të thotë vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, nëse nuk është i mundur, evidentimi i vlerës së drejtë të atij instrumenti nga krahasimi me transaksione të tjera të ndodhura në treg për instrumenta të njëjtë (pa modifikime) ose mund të bazohet në metoda vlerësimi faktorët e ndryshueshëm të të cilave përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi njihet më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se sa kur vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni është mbyllur.

Aktivitet dhe pozicionet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka pozicione me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmimet “mid-market” përdoren për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe çmimi i kërkuar ose ofruar axhustohet, vetëm për pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin korrigjime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të kundër partisë tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përfutur nga modelet korrigjohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do t'i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**g) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidence objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidencë objektive që tregon se aktivi është zhvlerësuar mund të jetë, mospagimi ose shkelja nga huamarrësi, ristrukturimi i kredisë ose paradhënies nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Banka konsideron mundësinë e zhvlerësimit të huave dhe paradhënies dhe letrave me vlerë të mbajtura deri në maturitet në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë huatë individualisht të rëndësishme, paradhëniet dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim testohen individualisht për zhvlerësim. Të gjithë huatë, paradhëniet dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim të cilat nuk zhvlerësohen në mënyrë individuale testohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim që mund të ketë ndodhur por që nuk është identifikuar akoma. Huatë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim të cilat nuk kanë individualisht një vlerë të konsiderueshme testohen kolektivisht për zhvlerësim duke grupuar bashkë huatë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim me karakteristika të njëjta rreziku.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të ecurisë historike të mundësisë së mospagimit, kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të huadhënies janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Mundësia e mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen vazhdimisht përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të jenë të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura e shpenzime dhe pasqyrohen në një llogari fondi për humbjet nga zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve ose letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Kur një ngjarje mbas njohjes se zhvlerësimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje reflektohet në humbje ose fitim.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për shitje, nëse ka, njihen duke klasifikuar humbjet e akumuluar në rezervën e rivlerësimit në kapital në fitim ose humbje. Humbja që njihet është diferenca midis vlerës së blerjes e netuar për çdo pagesë principali apo amortizim, dhe vlerës së drejtë ekzistuese, pakësuar nga çdo humbje nga zhvlerësimi që është njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimi në provizione si pasojë e aplikimit të metodës së interesit efektiv pasqyrohen si të ardhura nga interesat. Nëse në periudha të mëvonshme vlera e drejtë e letrave me vlerë të mbajtura për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur, atëherë humbja e njohur më parë anulohet me shumën e anuluar të njohur në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rikuperim i mëvonshëm i vlerës së drejtë të letrave me vlerë të mbajtura për shitje njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**h) Aktive monetare dhe ekuivalentet me to**

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë gjëndjen në arkë, depozitat me Bankën Qëndrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël.

i) Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose për një periudhë afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes ose huadhënie të siguruara nga letra me vlerë), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivi në fjalë nuk paraqitet në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kostot e lidhura direkt me transaksionin dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Investimet në letra me vlerë

Letrat me vlerë të investuara fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë ose si të vlefshme për shitje.

(i) Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë ti mbajë deri në maturim dhe ato nuk janë matur me vlerë të drejtë ose klasifikuar si të mbajtura për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i një vlere të konsiderueshme të investimeve të mbajtura për shitje jo afër maturitetit do të sjellë riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturitet si investime të mbajtura për shitje dhe e ndalon Bankën ti klasifikojë si investime të mbajtura deri në maturim për vitin aktual dhe dy vitet e ardhshme.

(ii) Investime të mbajtura për shitje

Investimet e mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk përfshihen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të kapitalit neto të pa kuotuar vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet me besueshmëri mbahen me kosto. Të gjithë investimet e tjera të mbajtura për shitje mbahen me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Të ardhurat ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve të kapitalit të mbajtura për shitje njihen në fitim ose humbje. Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e të ardhurave krahasuese deri kur investimet shiten ose zhvlerësohen dhe fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave krahasuese riklasifikohen në fitim ose humbje.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**k) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara janë matur me koston e blerjes duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Jeta e përdorimit llogaritet në bazë të pritshmërisë së Drejtimit për jetëgjatësinë e aktivit.

Amortizimi llogaritet me metodën lineare me normat e parashikuara për të ulur koston ose vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Vitet e pritshme të përdorimit janë si më poshtë:

Përmirësime në aktivet e marra me qira	4-10 vjet
Paisje dhe instalime	10 vjet
Automjete	10 vjet
Makineri dhe paisje elektronike	10 vjet
Kompjutera dhe paisje informatike	5 vjet
Paisje të tjera zyre	10 vjet

Aktivet nuk amortizohen derisa ato futen në përdorim dhe transferohen nga aktive të qëndrueshme në proces në kategorinë përkatëse të aktiveve.

l) Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet me metodën lineare mbi jetën e përdorimit të aktivit. Jeta e përdorimit është si më poshtë:

Patenta dhe licenca	5 vjet
Programe kompjuterike dhe aktive të tjera të patrupëzuara	5 vjet

m) Aktive të mbajtura për shitje

Aktivet e përftuara nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve të huave dhe paradhënies të klientëve, që nuk mbahen për shitje, nuk përfitohet qera, nuk përdoren dhe mbahen me qëllimin për t'u nxjerrë jashtë përdorimit në një periudhë të shkurtër kohe, pa një riskstrukturim të rëndësishëm klasifikohen si inventar. Aktivet e përftuara paraqiten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo fshirje njihet në të ardhura apo shpenzime. Çdo fitim apo humbje nga njerrja jashtë përdorimit njihet në të ardhura apo shpenzime.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**n) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rekuperueshme e aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon vlerën e rekuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahet në fillim duke ulur vlerën kontabël të emrit të mirë të shpërndarë tek njësitë dhe pastaj shpërndahet vlera kontabël e aktiveve të tjera në njësi (grupin e njësite) në një bazë propocionale.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së përdorimit dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parashikuara të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

o) Depozitat

Depozitat janë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të ri-blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që ti mbajë detyrimet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave ose shpenzimeve.

p) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

q) Standartet e reja dhe interpretimet në periudhën aktuale

Amendimet e mëposhtme të standarteve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet të lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar janë efektive për periudhën aktuale:

- **Amendamentet e SNK 19 “Përfitimet e Punonjësve”** - Planet e Përcaktuara të Përfitimeve: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 korrik 2014),
- **Amendamente për standarde të ndryshme “Përmirësimet në SNRF (periudha 2010-2012)”** që rezultojnë nga përmirësimet e projekteve vjetore të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (amendamentet duhet të zbatohen për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 korrik 2014),
- **Amendamente për standarde të ndryshme “Përmirësimet në SNRF (periudha 2011-2013)”** që rezultojnë nga përmirësimet e projekteve vjetore të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (amendamentet duhet të zbatohen për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 korrik 2014),

Përshtatja e këtyre amendamenteve me standartet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndryshime në politikat kontabël të Shoqërisë.

(r) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standartet e reja, interpretimet dhe amendamentet e Standardeve në vijim janë publikuar por nuk janë ende efektive dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- **SNRF 9 “Instrumentat Financiare”** (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2018),
- **SNRF 14 “Llogaritë Rregullatore të Shpenzime të Shtyra”** (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **SNRF 15 “Të Ardhura nga Kontratat me Klientë”** (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2017),
- **SNRF 16 “Qiratë”** (efektive për periudhat vjetore filluar në ose pas datës 1 janar 2019),
- **Amendamentet e SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje”** - Shitja ose Dhurimi i Aktiveve midis një Investitori dhe Pjesëmarrësve dhe amendime të tjera (data efektive është shtyrë për një kohë të pacaktuar derisa projekti i kërkimit për metodën e kapitalit të përfshihet)
- **Amendamentet e SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara”, SNRF 12 “Dhënie e informacionit shpjegues për interes të njëjësive të tjera ekonomike” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje”** - Njësitë Investuese: Zbatimi i Përgjashtimeve nga Konsolidimi (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **Amendamentet e SNRF 11 “Marrëveshjet e Përbashkëta”** - Kontabilizimi i Blerjeve të Interesave në Operacione të Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Standarde të reja dhe interpretime që ende nuk kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

- **Amendamentet e SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** - Njohja Fillestare (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **Amendamentet e SNK 12 “Tatim fitimi”** - Njohja e aktivitetit tatimor të shyrë për humbjet e perealizuara (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2017),
- **Amendamentet e SNK 16 “Aktivet Afatgjata Materiale” dhe SNK 38 “Aktivet Jo-materiale”** - Sqarime për Metodën e Pranuara të Amortizimit dhe Zhvlerësimit (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **Amendamentet e SNK 16 “Aktivet Afatgjata Materiale” dhe SNK 41 “Bujqësia”** - Bujqësia: Bimët Bartëse (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **Amendamentet e SNK 27 “Pasqyrat Financiare të Vecanta”** - Metoda e Kapitalit në Pasqyrat Financiare të Vecanta (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),
- **Amendamente për standarde të ndryshme “Përmirësimet në SNRF (periudha 2012-2014)”** që rezultojnë nga përmirësimet e projekteve vjetore të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (amendamentet duhet të zbatohen për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 janar 2016),

Banka ka zgjedhur të mos i zbatojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës së tyre të hyrjes në fuqi. Banka parashikon që zbatimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj në periudhën e zbatimit fillestar.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut

Më poshtë paraqiten llojet e ndryshme të rrezikut ndaj të cilave Banka është e ekspozuar si rezultat i aktiviteteve jo-tregtare dhe përjasja e ndërmarrë për të menaxhuar këto rreziqe.

a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimet e përgjithshme të aktiviteteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin si rrezikun e paaftësisë për të financuar aktivet me maturitet dhe normat e përshtatshme ashtu edhe rrezikun e paaftësisë për të likuiduar një aktiv me një çmim dhe brënda një afati kohor të arsyeshëm për të përmbushur detyrimet.

Fondet krijohen duke përdorur një sërë instrumentash duke përfshirë depozitat dhe kapitalin e paguar. Kjo rrit fleksibilitetin e fondeve, kufizon varësinë nga një burim i vetëm financimesh dhe përgjithësisht ul koston e fondeve. Banka përpiket për të ruajtur balancën midis vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit, nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të shpërndara në kohë. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet e duhura në financime, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vendosura në strategjinë e Bankës. Më 31 dhjetor 2015 tridhjetë depozituesit jo-financiarë më të mëdhenj përbëjnë 10.4% (2014: 10%) të totalit të depozitave nga klientët. Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas grupimeve përkatëse të maturitetit bazuar në periudhat e mbetura të shlyerjeve.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe
4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)
a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)
Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2015

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti i pa- përcaktuar	Gjithsej
Aktivet financiare						
Aktive monetare dhe balancat me Bankën Qëndrore	226,854	-	-	-	-	226,854
Shuma të kushtëzuara	-	-	-	-	1,391,421	1,391,421
Investime të mbajtura për shitje	115,547	343,263	693,092	4,227,878	-	5,379,780
Aktive financiare të mbajtura në maturim	208,265	253,916	408,867	1,086,509	-	1,957,557
Hua dhe paradhënie me bankat dhe institucionet financiare	1,238,433	-	-	-	-	1,238,433
Hua dhe paradhënie me klientët	341,657	80,171	637,170	5,139,087	-	6,198,085
Gjithsej	2,130,756	677,350	1,739,129	10,453,474	1,391,421	16,392,130
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj bankave	197,855	-	-	-	-	197,855
Detyrime ndaj klientëve	6,540,043	870,272	5,087,638	2,211,376	-	14,709,329
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	135,035	-	-	-	-	135,035
Gjithsej	6,872,933	870,272	5,087,638	2,211,376	-	15,042,219
Hendeku i likuiditetit neto	(4,742,177)	(192,922)	(3,348,509)	8,242,098	1,391,421	1,349,911

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
në mijë Lekë, përveçse kur shprehur ndryshe
4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)
a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)
Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2014

	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti i pa- përcaktuar	Gjithsej
Aktivet financiare						
Aktive monetare dhe balancat me Bankën Qëndrore	234,623	-	-	-	-	234,623
Shuma të kushtëzuara	-	-	-	-	1,381,314	1,381,314
Investime të mbajtura për shitje	80,359	549,223	1,319,423	714,513	-	2,663,518
Aktive financiare të mbajtura në maturim	206,835	256,245	100,205	1,907,568	-	2,470,853
Hua dhe paradhënie me bankat dhe institucionet financiare	2,872,821	-	-	-	-	2,872,821
Hua dhe paradhënie me klientët	160,627	148,297	544,122	5,016,658	-	5,869,704
Gjithsej	3,555,265	953,765	1,963,750	7,638,739	1,381,314	15,492,833
Detyrimet financiare						
Detyrime ndaj klientëve	6,010,472	1,269,871	6,666,491	358,780	-	14,305,614
Gjithsej	6,010,472	1,269,871	6,666,491	358,780	-	14,305,614
Hendeku i likuiditetit neto						
	(2,455,207)	(316,106)	(4,702,741)	7,279,959	1,381,314	1,187,219

